

VENDIM
Nr. 258, datë 5.5.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 175, DATË 17.3.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E SPITALIT RAJONAL ‘MEMORIAL’ NË FIER, SI PROJEKT
PILOT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 175, datë 17.3.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

- a) Shkronja “c”, e pikës 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“c) një përfaqësues i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë;”.
- b) Pas pikës 19, të shtojcës nr. 1, “Lista e shërbimeve spitalore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e vendimit nr. 175, datë 17.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 19/1, me këtë përmbajtje:
“19/1. Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, atomopatologjikë, gjenetikë mjekësorë, laborator i mjekësisë nukleare);”.

II. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe